



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Uran Agim Dibranit.
- II. Prona e paluajtshme komunale P.Sh Rrugë K.K.Prishtina që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës kadastrale nr. 04565-2, me sip.152m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-04565-2, Zona Kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Tophane", i miratuar me vendimin nr. 01nr.35-374, dt.03.04.2008, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale nr. 04562-0, sip.152m², Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-04562-0, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të: Uran Agim Dibrani, me destinim rrugë të planifikuar sipas Planit Rregullues "Tophane", i miratuar me vendimin nr. nr.01nr.35-374, dt.03.04.2008 dhe PZHU-së.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Tophane" në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05nr.350/03-19391/20,dt.09.02.2021, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr.4565-2, sip.152m², Z.K Prishtinë në pronësi të P.Sh Rrugë K.K.Prishtina, e cila gjendet në kuadër të bllokut urban "T13" të planit rregullues "Tophane", i miratuar me vendimin nr. 01nr.35-374, dt.03.04.2008, dhe PZHU-së, dhe parcela me nr. 4562-0, sip.152m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të: Uran Agim Dibrani, me destinim rrugë të planifikuar sipas Planit Rregullues "Tophane", i miratuar me vendimin nr. nr.01nr.35-374,dt.03.04.2008 dhe PZHU-së.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit Rregullues "Tophane", i miratuar me vendimin nr. 01nr.35-374, dt.03.04.2008, dhe Vendimin për Caktimin e Kushteve Ndërtimore me nr. 05nr.350/03-19391/20, dt.09.02.2021. Pjesa e Parcelës me nr.4565-2, Zona Kadastrale Prishtinë shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa parcela me nr.4562-0, Zona Kadastrale Prishtinë shtrihen në infrastrukturë publike-rrugë të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-82522/21, më 12.05.2021

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

